

VILAJETI I SHKODRËS NË LUFTËN E PARË BALLKANIKE (1912-1913) (Në këndvështrimin e historianëve dhe arkivave osmane)

Shkodra është një ndër pikat më kryesore strategjike në Ballkan. Emri Shkodër është shqip. Sipas Sami Frashërit fjala “Shkodër” është në gjuhën shqipe dhe vjen nga fjala “korda”. Por krahas kësaj, Shkodra është njohur në histori me emra të tillë si Shkodër, Skord, Skoder, Scutari, Alexandria (Iskenderije), Skadar dhe Scodre.¹ Në shekujt XI-XIII Shkodra (Scutari) ishte zonë e dominuar midis Bizantit dhe principatës serbe të Zetës. Në vitet 1360-1393 ajo u bë qendra e Principatës së Balshajve. Edhe pse qyteti u mor nga komandanti osman Shahin Kavala, kjo nuk zgjati shumë (1393-1396). Gjergj Strazimir Balsha ua dorëzoi qytetin venecianëve në vitin 1396. Venecianët, të cilët e fortifikuan qytetin, e mbajtën nën kontroll deri në vitin 1479, dhe këtë vit me një marrëveshje ia dhanë Fatih Sulltan Mehmetit.² Historiani turk Sylejman Kylçe thotë se, para pushtimit osman disa princër nga Normanët, të cilët ishin vendosur në Francë, kanë ardhur dhe janë vendosur në këtë zonë të Shkodrës, afër detit. Familja më e madhe e tyre janë ata që kanë realizuar arritje të mëdha në historinë administrative turke. Kjo familje në turqisht quhet “Dukaginzadeler” (Dukagjinasi).³

Për shkak të vendndodhjes së saj gjeografike, Shkodra ishte e vështirë të sundohej dhe osmanët mundën ta vendosnin kontrollin e plotë në rajon vetëm një shekull pas kalimit të tyre të parë në Rumeli.⁴ Fatih Sulltan Mehmeti pasi mori Shkodrën në vitin 1479,⁵ praktikisht arriti vendosjen

-
- 1 Sami Frashëri/Şemsedin Sami, *Kamusül-Alâm*, Dersaadet 1316, V. II, f. 978; Ali Bardhi, *Müfettiş Davut Boriçi'nin Günlüğünde* (1870-1877) İškodra Vilayeti'nde Eğitim, Marmara Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Yüksek Lisans Tezi, İstanbul 2009, f. 14.
 - 2 Machiel Kiel, “İškodra”, *Türk Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi (DLA)*, İstanbul 2001, V. 23, f. 433.
 - 3 Süleyman Külçe, *Osmanlı Tarihi'nde Arnavutluk*, İzmir 1944, f. 372-373.
 - 4 Ali Fuat Öreñç, *Balkanlarda İlk Dram: Unuttuğumuz Mora Türkleri ve Eyaletten Bağımsızlığa Yunanistan*, BKY Yay., İstanbul 2009, f. 15.
 - 5 Halil İnalçık, *Arnavutluk'ta Osmanlı Hakimiyetinin Yerleşmesi ve İskender Bey İsyanının Menşei, “Fatih ve İstanbul Dergisi”*, V. I., No: II., ff. 152-175, İstanbul 1953.

e sundimit osman në të gjithë Shqipërinë e më gjerë. Osmanët e morën Shkodrën vetëm me një marrëveshje që bënë me venecianët. Sipas kushteve të traktatit, një pjesë e banorëve kishin evakuuar qytetin dhe kishin emigruar në territoret veneciane. Vilajeti, pasi hyri nën sundimin osman, u shndërrua në një qendër të rëndësishme administrative dhe kulturore nën këtë administratë. Sipas regjistrit Tahrir të vitit 1485, kishte disa qindra ushtarë në kala dhe kishte gjithashtu një popullsi civile prej 97 shtëpish (rreth 450-500 njerëz), njëzet e shtatë prej tyre myslimanë. Emrat e këtyre xhamive janë regjistruar në “Defterin e Regjistrimeve të Xhamive në Rumeli” të vitit 1637, dhe pjesërisht në regjistrat osmanë të shekullit XVI. Qyteti i Shkodrës, gjatë fillimeve të sundimit osman, përbëhej nga gjashtë lagje të njohura si: Haxhi Resuli, Ali Begu, Vreshta, Karshi, Ajazma dhe Tepeja. Me kalimin e kohës, qyteti u zgjerua dhe u krijuan lagjet Tophane, Rus i Madh, Rusi i Vogël, Perashi Zir, Perashi Bardhë, Nevçaji, Parruca dhe Dudasi.⁶ Evlija Çelebi shkruan që Shkodra e shekullit të 17-të ka pesëmbëdhjetë lagje dhe 1800 familje dhe e cilëson si një qytezë me madhësi të mesme.

Shkodrës filloi t’i rritet rëndësia më shumë në shek. XVIII. Kjo, pasi qyteti u bë qendra e familjes shqiptare të Bushatllinjve. Sundimi i familjes së Bushatllinjve u bë në vitet 1756-1831. Osmanët e larguan këtë familje në vitin 1831. Bushatllinjtë ndërtuan Xhaminë e Plumbit, e cila është xhamia më e rëndësishme dhe më e madhe në të gjithë Vilajetin e Shkodrës (1773). Në shekullin e 18-të, Shkodra ishte një qendër e zhvilluar tregtare me tri zona (Tophane, Terzihane dhe Tabak) dhe njëzet e pesë lagje. Popullsia myslimane ishte 8000 familje dhe katolikët 600 familje: Gjithashtu, qyteti kishte një kishë dhe dyzet xhami. Ndërsa në kala kishte 150 familje myslimane dhe dy xhami.

Pas reformave të realizuara me Fermanin e Tanzimatit në vitin 1839, Shkodra u bë një qendër e madhe, dhe kufijtë administrativë të saj shtriheshin që nga Kavaja e Durrësi, duke përfshirë mbarë pjesën veriore të Shqipërisë së sotme dhe Malësinë. Pas luftës osmano-ruse (1877-1878), për Portën e Lartë, rëndësia ushtarake e Shkodrës u rrit edhe më shumë. Kjo ishte një pikë kthese, sepse po atë vit në Kongresin e Berlinit, tokat ku jetonte popullsia shqiptare në veri iu dhanë Malit të Zi dhe Serbisë, ndërsa në jug, Greqisë. Gjatë kësaj periudhe, krahina e Shkodrës ishte e

6 Halil İnalçık, Süret-i Defter-i Sancak-i Arvanid, Türk Tarih Kurumu Basımevi, II. Baskı, Ankara 1987.

rëndësishme, për sa i përket kufirit me Malin e Zi.

Salname (defteri) e Vilajetit të Shkodrës e vitit 1310 h. (1892), e përshkruan qytetin e Shkodrës kështu:

“Në veriperëndim kufizohet me liqenin e Shkodrës e Tuzin, në lindje me Mirditën e Pukën, në perëndim është e rrethuar nga Mali i Zi dhe deti Adriatik. Qyteti është vetëm 9 metra mbi nivelin e detit. Banorët e saj janë shumicë myslimane”.⁷

Në fundin e shek. XIX, Vilajeti i Shkodrës, në veri kufizohej me Malin e Zi, në perëndim me detin Adriatik, në lindje me Vilajetin e Kosovën dhe në jug me Vilajetet e Manastirit e të Janinës.

Vilajeti kishte dy sanxhakë, Shkodrën dhe Durrësin, dhe qendra ishte qyteti i Shkodrës. Po ashtu Sanxhaku i Shkodrës përbëhej nga 6 kaza, Tuzi, Lezha, Kruja, Ulqini, Puka dhe Mirdita. Ndërsa Sanxhaku i Durrësit kishte 4 kaza, Durrësin, Tiranën, Kavajën dhe Shijakun.⁸

Po ashtu, edhe Sami Frashëri në “Kamûsü'l-A'lâm” shkruan që Vilajeti i Shkodrës në fundin e shek. XIX kishte 4500 familje, 1500 dyqane dhe markata, një pazar të mbuluar, rreth 40 xhami, 2 medrese, 1 bibliotekë, 1 shkollë të mesme dhe shumë shkolla fillore. Gjithashtu, sipas tij, aty kishte edhe ndërtesa të shumta administrative të qeverisë, kazerma dhe municione. Qyteti ka një popullsi prej afërsisht 37 mijë vetash, prej të cilëve tre të katërtat janë myslimanë dhe një e katërta të krishterë. Të gjithë këta ishin shqiptarë.⁹

Në Vilajetin e Shkodrës deri në vitin 1894 nuk është bërë regjistrim i përpiktë i popullsisë. Në këtë vit numërimi i popullsisë dhe i vendeve u përfshinë në vjetarin e Vilajetit të Shkodrës. Qyteti përbëhej nga 14 lagje, dymbëdhjetë prej të cilave ishin me popullsi myslimane. Numri i popullsisë ishte 41000 banorë, nga të cilët dy të tretat ishin myslimanë dhe një e treta katolikë. Duhet thënë se 100 familje, me rreth 600 vetë ishin ortodoksë. Struktura e Vilajetit të Shkodrës mbeti e njëjtë deri në fund të sundimit osman.¹⁰ Po ashtu nuk duhet harruar se ky vilajet ka nxjerrë burra në çdo fushë të jetës sociale, politike dhe ushtarake që kanë shërbyer në çdo cep të Perandorisë Osmane.¹¹

7 *Salname-i Vilayet-i İşkodra (SVI)*, Sene 1310, f. 58.

8 Yakup Ahabab, “The Shkodra Banner Administrative Structure During The Tanzimat Period (1839-1876)”, *Balkan Studies History & Literature*, (Ed. Deniz Ekinçi), V. II, Arnautluk 2012, f. 673-680.

9 Sami Frashëri/Şemseddin Sami, *Kamûsü'l-A'lâm*, Dersaadet 1316, V. 2, f. 62.

10 *SVI*, sene 1312, f. 64.

11 M. Kiel, *po aty* f. 434.

Sipas Traktatit të Berlinit, të nënshkruar pas luftës osmano-ruse në vitet 1877-1878, në vilajet u bënë ndryshime të mëdha. Shteti osman u desh të linte shumë pjesë të Shkodrës nën Malin të Zi të sapokrijuar.¹² Porta e Lartë, pas Kongresit të Berlinit, në Ballkan kishte pesë vilajete të tjera përveç Shkodrës. Nga këto, përveç Vilajetit të Edirnesë, të katër të tjerat ishin me popullsi shqiptare, përkatësisht: Vilajeti i Manastirit, Vilajeti i Kosovës, Vilajeti i Janinës¹³ dhe Vilajeti i Selanikut. Vilajeti shqiptar (në osmanisht ولايت ارنأود /Arnavud Vilâyet-i) ishte një vilajet i planifikuar për t'u krijuar nga vilajetet me shumicë shqiptare në Gadishullin e Ballkanit Perëndimor, brenda territorit të Perandorinë Osmane, ku përpos Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës u planifikua të përfshihej edhe Vilajeti i Selanikut (ose një pjesë e tij), siç e cilëson Nathalie Clayer:

*“Përkundër asaj që pohohet shpesh, pretendimi për një territor që përfshin Vilajetin e Selanikut ishte mjaft i shpeshë”.*¹⁴

Këtë pohim e shohim edhe në hartat e vizatuara me dorë nga ish-themeluesi dhe rektori i parë i Universitetit të Stambollit (Daru-l Funun) Hasan Tahsini¹⁵, po ashtu edhe në amanetin që iu lë studentëve të tij, rilindësve. Hasan Tahsini këtë e lë si amanet dhe një ditë para se të ndërronte jetë, e thekson edhe në reportazhin e dhënë për revistën, të cilën ai vetë e kishte themeluar bashkë me të tjerë, t dhe që e drejtonin studentët e tij, Hazine-i Evrak Mecmuası, revistën “Thesar dokumentesh”. Ky ishte edhe reportazhi i parë modern në gazetarinë e Perandorisë Osmane.¹⁶ Krijimi i një vilajeti të veçantë shqiptar ishte në agjendën e rilindësve shqiptarë të Stambollit të kryesuar nga Hasan Tahsini. Po ashtu, edhe organizatat shqiptare në periudhën e njohur si “Rilindja Kombëtare Shqiptare” që nga viti 1877 e kishin në agjendë.

Krijimi i vilajetit shqiptar u vendos më 4 shtator 1912, pas revoltës shqiptare të vitit 1912, por negociatat u ndërpre, pasi në tetor filloi Lufta e Parë Ballkanike. Në Stamboll, plani për një vilajet shqiptar (Arnavut

12 BOA, *Yıldız Esas Evrakı* (Y. EE), 79/8.

13 Yakup Ahbab, *po aty*, f. 679.

14 Nathalie Clayer, (2007). *Aux origines du nationalisme albanais: la naissance d'une nation majoritairement musulmane on Europe*. Karthala. f. 463.

15 Në Shtojcë janë 5 hartat e “Arnavut Vilayeti/Vilajeti Shqiptar”, të bëra nga hoxhë Hasan Tahsini, ku si shumë libra të tij shkencorë ato botohen 10-15 vite pas vdekjes së tij, dhe dalin në dritë pas një shekulli e gjysmë.

16 Mahmud Celaledin, *Hoca Tahsin Efendi ile Mükalememiz (Röportaj)*, Hazine-i Evra Mecmuası No: 22, ff. 343-347, 2 Temmuz 1881, Türkçe transkripsyon ve tercüme Sidita Brahaj, 2 Temmuz 2018.

Vilayeti) përfundoi kur Shqipëria shpalli pavarësinë me 28 nëntor.

“E para, më e moderuara dëshironte që pesë vilajetet (kjo do të përfshinte Selanikun) që ishin të banuara nga shqiptarë të bashkoheshin në një vilajet të vetëm ... plani merr mbështetjen e konservatorëve. Grupi më radikal dëshironte bashkimin e vetëm katër vilajeteve, por me një autonomi të plotë administrative”.¹⁷

Shkodra në prag të luftërave ballkanike

Në fund të shek. XIX, rëndësia e tokave shqiptare për mbizotërim në Adriatik dhe Ballkan rriti konkurrencën midis Austrisë, Serbisë, Italisë dhe Rusisë. Po ashtu, Anglia duke përkrahur Italinë dhe Gjermania shtetin e Austrisë ishin në një luftë indirekte për të pasur ndikimin e tyre mbi tokat shqiptare.¹⁸ Duhet kuptuar që në këtë periudhë midis udhëheqësve shqiptarë kishte mosmarrëveshje të thella për qëllimet kombëtare. Disa prej tyre nuk dëshironin asgjë më shumë se përmbysjen e regjimit të xhonturqve në Perandorinë Osmane, e të tjerët kërkonin autonomi të plotë administrative.¹⁹

Një nga vendet e sapokrijuara në Ballkan, Serbia, nuk kishte kufi me detin, dhe i duhej që komunikimin me detin ta bënte përmes territoreve të sunduara nga Austria. Për këtë, Serbia synonte pushtimin e tokave veriore shqiptare, që të kishte një port në detin Adriatik.²⁰ Austria, për të mbajtur larg Serbinë nga Adriatiku, e konsideroi se rruga më e mirë ishte të investonte në ngritjen e vetëdijes kombëtare te shqiptarët.²¹ Sipas Vjenës, një Shqipëri e pavarur ishte mënyra më efektive për të parandaluar zgjerimin e Serbisë drejt Perëndimit.²² Por kjo strategji e Austrisë për shqiptarët ishte në kundërshtim me ambiciet greke në Epir. Rritja e një patriotizmi kombëtar shqiptar ka qenë problem i rëndësishëm që i ka afruar të tri vendet e Ballkanit, kundra shqiptarëve.

Austria dhe Italia kishin vendosur se në rast se statusquo-ja përkeqësohej,

17 Charles Jelavich & Barbara Jelavich, (1986). The establishment of the Balkan national states, 1804–1920. University of Washington Press. f. 86.

18 Bilgin Çelik, “Ballkanlarda Arnavut Sorunu”, *Cumhuriyet Strateji*, Ocak 2005, f.16-18.

19 Barbara Jelavich, *Balkan Tarihi 20. Yüzyıl*, c.II, Küre Yay., İstanbul, 2006, f. 93.

20 *İkdam*, 12 Kasım 1912.

21 Bonyar Eaylet – Ernst Jackh, İmparatorluk Stratejileri ve Ortadoğu: Doğu-da İngiliz Alman Rekabeti ve Balkan Savaşından Sonra Almanya, Chiviyazıları Yay., İstanbul, 2004, f. 295.

22 Necdet Hayta, *Ege Adaları Sorunu 1911'den Günümüze*, Gazi Kitabevi Yay., Ankara, 2006.

do ta bënin Shqipërinë një shtet autonom ose të pavarur.²³ Kjo, sepse Shqipëria ishte një garanci për Austrinë dhe një rezultat i pranueshëm edhe për Rusinë.²⁴ Britania ishte kundër dominimit të Austrisë dhe Rusisë në Ballkan. Përballë pretendimeve të Austrisë për shqiptarët katolikë dhe të Rusisë për shqiptarët ortodoksë, Britania përqafoi idenë e krijimit të një Shqipërie të pavarur.²⁵

Në këtë kohë shteti osman ishte i zënë me probleme të brendshme dhe dita-ditës humbte toka në të katër anët e perandorisë. Opozita bënte presionin e vet ndaj qeverisë dhe po ashtu problemet e politikës së jashtme shtoheshin dita-ditës.²⁶ Ndërkohë, vendimet e miratuara nga parlamenti në lidhje me masat që duhej të merreshin nga qeveria osmane në Rumeli, me reformat politike që duheshin zbatuar dhe masat paraprake që duheshin marrë u përcollën nga qeveria tek autoritetet përkatëse. Ndër ta, më të rëndësishmet ishin, që të formohej nga një stacion ose batalion i xhandarmërisë me një prezencë prej 1000 ushtarësh në Vilajetin e Kosovës, 1000 në Vilajetin e Shkodrës dhe 1000 në Vilajetin e Janinës. Për Vilajetin e Manastirit dhe të Selanikut u kërkua që të plotësoheshin mangësitë sa më shpejt të ishte e mundur.²⁷ Për koston e ndërtimit të stacioneve të xhandarmërisë ose marrjen me qira të vendeve të përshtatshme derisa ato të ndërtoheshin, buxheti total ishte 192 000 lira ari. Për këtë buxhet u kërkuan 46 000 lira nga Vilajeti i Selanikut, 60 000 nga Vilajeti i Kosovës, 25 000 nga Vilajeti i Manastirit, 25 000 nga Vilajeti i Shkodrës dhe 36 000 nga Vilajeti i Janinës. Me këtë buxhet do të hynin në funksion edhe 103 stacione të xhandarmërisë në Selanik, 225 në Kosovë, 106 në Manastir, 94 në Shkodër dhe 160 në Janinë.²⁸ Ndërsa për telekomunikacionin e kohës që do bënte lidhjen e stacioneve të policisë me njëri-tjetrin, edhe pse ishte vendosur të ndaheshin 10 000 lira më parë, u pa se ato nuk do të mjaftonin.²⁹

Tashmë dihet që kishte shumë arsye për shpërthimin e Luftërave Ballkanike. Por lufta ndërmjet fuqive të kohës për të copëtuar dhe përfutur

23 Süleyman Kani İrtem, *Osmanlı Devleti'nin Makedonya Meselesi, Balkanların Kördüğümü*, (Haz. O. S. Kocahanoglu), Temel Yay., İstanbul, 1999, f.137.

24 J.M. Roberts, *Yirminci Yüzyıl Tarihi*, (Çev. Sinem Gül), Dost Kitapevi, Ankara, 2003, f. 191.

25 Muzaffer Tepekaya, "Osmanlı-Alman İlişkileri (1870-1914)", *Türkler*, Yeni Türkiye Yayınları, c. 13, Ankara, 2002, f. 40.

26 Enver Ziya Karal, *İkinci Meşrutiyet ve Birinci Dünya Savaşı (1908-1918)*, TTK Yayınları, c. 9, 3. baskı, Ankara, 2001, f. 154.

27 Selim Aydın, *Balkanların Acı Yüzü: Basın Tarihinde Balkan Savaşları*, Yeditepe yayınları, İstanbul, 2013, f. 124.

28 Selim Aydın, *po aty*, f. 125.

29 BOA, *MV*, no. 161/55.

tokat e osmanëve në Rumeli, që shumica ishin toka shqiptare, mund të konsiderohet si arsyeja më e rëndësishme. Në këtë aspekt, mbreti bullgar Ferdinand I mori rezultatin e parë të rëndësishëm, duke nënshkruar një marrëveshje me Serbinë, më 13 mars 1912, kundra osmanëve. Më 29 maj, po ashtu nënshkruan marrëveshje edhe me Greqinë. Në këtë vazhdë, Serbia nënshkroi marrëveshje me Malin i Zi, më 6 shtator të po atij viti. Si pasojë e këtyre aleancave dhe përgatitjeve për luftë, më 30 shtator, Bullgaria dhe Serbia shpallën mobilizimin kundra Portës së Lartë. Të nesërmen, këtij mobilizimi i bashkohet edhe Mali i Zi dhe Greqia. Mali i Zi ishte shteti i parë ballkanik që i shpalli luftë Perandorisë Osmane, më 8 tetor 1912. Më 17 tetor hyjnë në luftë Serbia dhe Bullgaria, ndërsa Greqia duke iu bashkuar aleatëve të saj i shpall luftë Portës së Lartë, më 19 tetor.³⁰

Situata e ushtrisë osmane para Luftës Ballkanike, nuk ishte e mirë, po ashtu kishte edhe shumë probleme politike. Reformat që priteshin të bëheshin para luftës nuk ishin përfunduar. Mangësitë e ushtrisë tashmë ishin të njohura nga organet kompetente dhe nga armiqtë e saj, sepse kjo ushtri ishte provuar në luftën osmano-greke të vitit 1897. Edhe pse kishin kaluar 15 vite nga kjo luftë, reformat në ushtri nuk ishin bërë. Reformat në ushtrinë e perandorisë u bënë vetëm në Rumeli, dhe kjo ndodhi vetëm kur shtetet e Ballkanit forcuan strukturat e tyre ushtarake. Por këto reforma nuk jepnin frytë³¹ edhe pse ushtria osmane tashmë kishte 5 komandantë gjermanë në drejtimin e saj. Ushtria osmane u mund në Luftën Ballkanike. Humbja e ushtrisë osmane bëri që opinionin publik vendas dhe i huaj të vinte në pikëpyetje besimin në kompetencën e gjermanëve dhe të pashallarëve Goltz Pasha, Ahmed Izzet Pasha dhe Mahmud Shevket Pasha.³²

Me disfata të njëpasnjëshme, Porta e Lartë çdo ditë e më shumë po humbte kontrollin dhe në vilajetet që ishin në kufi me Stambollin. Edhe

30 BOA, *Babiali Evrak Odası (BEO)*, no. 305439; *BEO*, no. 305822; *BEO*, no. 306144; *BEO*, no. 306332; *Dosya Usulu İradeler (İ. DUİT)*, no. 10/25; Reginald Rankin, *The Inner History of The Balkan War*, London 1914; Rifat Uçarol, "Balkan Savaşı Öncesinde Terhis Olayları ve Seferberlik İlanı Sorunu", *Dördüncü Askeri Tarih Semineri, Bildiriler*, Ankara 1989, s. 272-276; Cevdet Küçük, "Balkan Savaşı", *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi (DİA)*, İstanbul 1992, c. V, s. 23-25; Richard C. Hall, *The Balkan Wars 1912-1913, Prelude to the First World War*, London 2000; Zekeriya Türkmen, "Balkan Savaşlarında Hilal-i Ahmer Cemiyeti'nin Osmanlı Ordusuna Yönelik Sağlık Hizmetleri", *Belleten*, (Ankara 2005), c. LXVIII, sa. 252, s. 483-518; Mahmud Belig Üzdil, *Balkan Savaşı'nda Mürettep 1 Nci Kolordunun Harekâtı*, Ankara 2006; Ahmet Yiğit, "Edirne Muhasarası (1912-1913)", *Edirne Müdâfîi Mehmed Şükrü Paşa*, (Haz. M. Sabri Koz), İstanbul, 2008, s. 83-191.

31 Yusuf Hikmet Bayur, *Türk İnkılap Tarihi-III (Trablusgarp ve Balkan Savaşları Osmanlı Asyasının Paylaşılması için Anlaşmalar-1911 başından Balkan Savaşı'na Kadar)*, TTK Yay., Ankara, 1983, f. 375-376.

32 Kazım Karabekir, *po aty*, f. 213

pse valiu i Vilajetit të Selanikut kishte dhënë informacion në kohë se Bullgaria kishte dërguar një sasi të madhe armësh dhe municionesh³³ afër kufirit osman³⁴, Porta e Lartë nuk e kishte më forcën për të vepruar në kohë. Ndërkohë Bullgaria kishte krijuar aleancën ortodokse për të marrë sa më shumë toka të perandorisë. Aleanca ortodokse e përbërë nga shtete që komplotonin edhe ndaj njëra-tjetrës, dita-ditës forcohej me një qëllim të vetëm.³⁵ Aleanca ortodokse u përdor vazhdimisht dhe nga Anglia dhe Austria. Ambasada e Bukureshtit i kishte raportuar Portës së Lartë se shteti austriak u përpoq të krijonte një aleancë midis Bullgarisë dhe Rumanisë kundër Perandorisë Osmane, në mënyrë që të krijonte një sferë të ndikimit në Ballkan.³⁶ Në fillim të qershorit të vitit 1912, shtypi italian shkruante se ekzistonte një aleancë midis katër vendeve të Ballkanit dhe se kjo aleancë duhet të perceptohet si e vërtetë dhe e pakthyeshme.³⁷

Nismat dhe negociatat për aleanca midis qeverive të Ballkanit ishin në qendër të shtypit europian. Në këtë periudhë lajmet për aleancën në shtypin europian, u përkthyen dhe u botuan edhe në shtypin osman, por këto zhvillime nuk konsideroheshin serioze nga qeveria e Portës së Lartë. Në fund, kur qeveria osmane e kuptoi seriozitetin e çështjes lidhur me këto aleanca midis qeverive të Ballkanit, çështjet kishin marrë udhën e tyre dhe parandalimi i tyre tashmë ishte pothuajse i pamundur.³⁸ Ndërsa negociatat e aleancave midis vendeve të Ballkanit vazhduan në fshehtësi apo edhe haptas, zhvillimi kryesor i rëndësishëm tashmë ishte qasja europiane. Nga ana tjetër, ndërsa shtetet e Ballkanit po bënë aleanca mes tyre dhe po përgatiteshin për luftë, Perandoria Osmane po merrej me luftën e ashpër pozitive-opozitive brenda vetes.³⁹

Shkodra në luftërat ballkanike

Qeveria e Portës së Lartë donte të ndryshonte papritmas formën administrative tradicionale dhe të rrënjosur për shekuj të shqiptarët. Me këtë ajo bëri gabimin fatal dhe krijoi një mospërkrahje mbarëkombëtare tek shqiptarët. Porta e Lartë u përpoq të mblidhte në katër vilajetet shqiptare

33 BOA, *BEO*, no. 4801/306064; *BEO*, no. 4029/302146.

34 48 BOA, *MV*, no. 169/14.

35 BOA, *BEO*, no.3993/299449.

36 BOA, *BEO*, no. 3997/299737.

37 *İkdam*, nr. 99, 03 Haziran 1912, f. 3.

38 Përparim Rexhepi, "Mbrotjja e Shkodrës (1912-1913)", Tiranë, 2001, f. 10.

39 *Gazete Gazetesi* 16 Eylül 1912 ve 34-49 sayılan arasında 15 sayı; *Alemdar*, nr. 46, 28 Eylül 1912, f. 1.

taksën “oktrova”, të cilën nuk arrinte ta mblidhte as në kryeqytetin e vet. Përpjekja për të vendosur barazinë e ligjit të Stambollit deri në pjesën më të largët të shtetit osman, tregonte qartë mungesë të përvojës së administratorëve të saj.⁴⁰

Sllavët, austriakët dhe italianët ishin në një luftë të vazhdueshme për pjesët veriore dhe perëndimore të Shqipërisë, të cilat ishin nën sundimin osman. Shkodra, në skajin perëndimor të veriut të Shqipërisë, ishte skena e ngjarjeve më dramatike në këtë luftë. Qeveria austriake ndiqte politikën e ndërhyrjes në lindje dhe do e bënte qoftë në mënyrë paqësore ose me luftë. Shekujt e fundit ajo ishte përpjekur të vendoste ndikimin e saj mbi Shqipërinë e Veriut me pretekstin për të mbrojtur shqiptarët katolikë. Vjena shpenzoi shumë para për këtë çështje për vite me radhë. Austria kishte ndërtuar kisha edhe në qytetet e veriut të Shqipërisë, edhe në malet më të largëta, me pretekstin për të mbrojtur ligjërisht katolikët. Për dekada me radhë, ajo kishte paguar pagat dhe plotësuar të gjithë kërkesat dhe nevojat e priftërinjve dhe peshkopëve katolikë shqiptarë, dhe natyrisht që tani që i duheshin, u kërkoi t'i shërbenin dëshirave dhe interesave të Austrisë.⁴¹

Ndërkohë malazezve u shtohet çdo ditë e më shumë oreksi për tokat shqiptare. Nga ana tjetër, qeveria që ndiqte një qëllim politik dytësor në Shkodër ishte gjithashtu Italia. Italianët nuk po përpiqeshin të arrinin qëllimet e tyre, as me fe, as me konservatorizëm, as me injorancë, as nga armët e as nga kryengritja e shqiptarëve. Përmes shkollave të jetimëve dhe shkollës industriale që ata kishin hapur me kohë, po rritnin një brez për t'i mbështetur ata. Kështu që me kalimin e kohës Italia synonte të fitonte e të përvetësonte (italianizonte) Shkodrën në këtë mënyrë. Nga ana tjetër, në Greqinë e Jugut, vazhdonin haptazi përgatitjet për marrjen e plotë të Vilajetit të Janinës. Greqia me ndihmën e Ruisë, Francës dhe Anglisë po përpiqej t'i kthente shqiptarët e krishterë në grekë, duke iu mohuar gjuhën dhe kombësinë. Greqia kishte hapur shkolla deri në Durrës dhe suksesi i grekëve në këtë çështje ishte i dukshëm.⁴²

Në fillim të vjeshtës së vitit 1912, qeveritë e Ballkanit kishin përfunduar shumicën e përgatitjeve të nevojshme për të filluar luftën. Aleatët ballkanikë kohët e fundit kishin blerë armët më moderne nga Franca. Porta e Lartë ishte e përqendruar në Betejën e Tripolit, dhe ky fakt ishte një mundësi e

40 Von Zambaur, Hortense, *Rrethimi i Shkodrës (10 tetor 1912 deri me 22 prill 1913)*, Shkodër, 2006.

41 Abdurrahman Nafiz, *po aty*, f. 31

42 BOA, *BEO*, no. 4081/306012.

mirë për të bërë marrëveshje midis qeverive të Ballkanit. Gjatë muajit tetor pritej vetëm shpallja e luftës.

Një çështje e rëndësishme për t'u cituar është se arsyeja që Mali i Zi u zgjodh që t'i shpallte luftë i pari shtetit osman ishte se Porta e Lartë nuk kishte dërguar ende përforcime ushtarake në atë rajon. Kështu që më 8 tetor 1912 Principata e Malit të Zi⁴³ i shpalli luftë Portës së Lartë. Bullgaria, Serbia dhe Greqia⁴⁴ e ndoqën më pas.⁴⁵ Për pak kohë e gjithë Shqipëria e Veriut u pushtua nga serbo-malazezët.⁴⁶ Kur filloi Lufta Ballkanike, Kalaja e Shkodrës ishte nën rrethim për një kohë të gjatë.⁴⁷

Mbrojtja e Shkodrës

Në këtë kohë, Vijaleti i Shkodrës, në Shkodër, Tiranë, Durrës, Zadrimë dhe Tuz kishte 9 batalione këmbësorie dhe 3-4 artilerie nga regjimente të ndryshme. Meqenëse shumica e guvernatorëve ishin ushtarakë, komanda e ushtrisë iu la këtyre. Në kalanë e shkatërruar të Shkodrës, për të mbrojtur kalanë dhe për të marrë nën mbrojtje municionet e luftës, si barut, municion dhe armë të vjetra, ishte një komandant kalaje në rangun e guvernatorit të rrethit ose një major dhe në shoqërimin e tij ishte një kapiten, një toger i parë, një nëpunës, një hoxhë dhe një oficer mjekësor.

Në përgatitjet për luftë, forcat sulmuese do të përbëheshin nga pesë regjimente këmbësorie. Këto të gjitha do të ishin nën komandën e drejtpërdrejtë të komandantit Hasan Riza Pasha. Katër sektorët ekzistues të automatikëve do të ishin së bashku me dy seri të baterive malore të zjarrit. Batalioni i shpejtë i artilerisë së fushës së zjarrit dhe të tjerët do të hapnin rrugën dhe ato do të sillleshin nga zona përtej Urës së Milotit. Në telegrafin që i ka dërguar Hasan Riza Pasha Portës së Lartë më 24 shtator 1912, tregon qartë që ai donte të ishte së bashku me Sadedin Beun aty, kështu që Sadedin Beu qëndroi në Shkodër. Por çdo lëvizje që bënte Porta e Lartë, nuk kishte sukses, sepse qeveria e saj ishte shumë vonë për çdo gjë.⁴⁸

Para luftës, ushtria e Shkodrës nën komandën e Hasan Rizait kishte

43 BOA, *DH. SYS*, no. 112-6/4-1-11.

44 BOA, *HR. SYS*, no. 1966/1.

45 BOA, *BEO*, no. 4095/307064.

46 Osmanlı Ordularının durumu için bakınız: BOA, *BEO*, no. 4140/310493.

47 Oya Şenyurt, "II. Mahmud'un Saltanatının Son Yıllarında İşkodra Kalesi ve Çevresi", *Tarih ve Uygurluk İstanbul Dergisi*, 4, Aralık 2013, f. 101.

48 Abdurrahman Nafiz Paşa, *po aty*, f. 174-178.

13 mijë ushtarë dhe 96 topa. Ushtria kryesore e rregullt ishte 6 mijë ushtarë, ku shumica e tyre ishin vullnetarë (shqiptarë) në mbrojtje të tokave amtare. Kjo ushtri gradualisht do të arrinte në 20 mijë ushtarë. Pesë ditë para se malazezët të shpallnin luftë iu kërkua buxhet Portës së Lartë për të vendosur disa anije në limanin e Shkodrës kundër fortifikimeve malazeze. Por përgjigjja nuk vjen në kohën e duhur dhe parapërgatitjet nuk u realizuan siç duhej.⁴⁹

Malazezët me ndihmën e sllavëve dhe me ndihmën e 5500 vullnetarëve austriakë, arritën që më 3 dhjetor në Çatalca të bëjnë marrëveshje me Portën e Lartë⁵⁰, dhe qyteti i Shkodrës të mbetet përkohësisht në administratën e perandorisë, por nuk iu lejua të merrte asnjë lloj ndihme më.⁵¹ Pas këtij armëpushimi, serbët vazhdimisht e thyen këtë marrëveshje.⁵² Edhe kisha ortodokse greke me propagandë nëpër kisha arriti që të dërgojë me vaporë në ndihmë të sllavëve e malazezëve mijëra ortodoksë nga Selaniku, së bashku me 26 topa artileri të rëndë. Kisha ortodokse ruse dhe greke ndihmonin me shuma të mëdha dhe me armë vazhdimisht Serbinë dhe Malin e Zi. Duke parë këtë strategji të sllavëve dhe aleatëve të tyre, Hasan Riza Pasha si strateg ushtarak që ishte, u kishte ndërtuar një sinagogë ushtarëve hebrej dhe ditën e dielë lejonte të bëhej meshë edhe për ushtarët ortodoksë.⁵³ Po ashtu, Hasan Riza Pasha, në objektet shtetërore, pranë flamurit osman kishte vendosur edhe flamurin shqiptar, dhe tregonte haptas që tani kjo luftë ishte për të mbrojtur vatanin e shqiptarëve. Pashai bisedonte dhe i tërhoqi në anën e vet shumë hoxhallarë e priftërinj katolikë që të luftonin së bashku për mbrojtjen e Shkodrës. Kjo strategji arriti të bindë një numër të konsiderueshëm të këtyre klerikëve.⁵⁴ Por, pas të gjitha këtyre ngjarjeve, me 30 janar, Hasan Riza Pasha u vra në afërsi të shtëpisë së tij. Pas tij, komandën e Shkodrës e mori Esat Pashë Toptani. Nën komandën e tij, sulmi që bënë malazezët me 7 shkurt për të pushtuar Shkodrën dështoi. Po ashtu dhe sulmet e serbëve me 8-9 shkurt dështuan. Edhe në sulmet e përgjakshme në periudhën shkurt-mars nuk arritën ndonjë sukses.⁵⁵

Deri në datën 19 prill 1913 rrethimi i Shkodrës vazhdonte, dhe për herë të parë pas 6 muaj rrethimi, në këtë datë flitet që Shkodra iu dorëzohet malazezve. Me datën 23 prill bëhet marrëveshja që Shkodra t'u dorëzohet

49 *Balkan Harbi Karadağ Cephesi*, C. III/3, f. 87; Andonyan, *po aty*, f. 290.

50 Andonyan, *a.g.e.*, s. 290; *Balkan Harbi Karadağ Cephesi*, C.III/3, f. 99-100.

51 *Balkan Harbi Karadağ Cephesi*, C.III/3, f. 143.

52 BAO, *MV*, no. 172/15.

53 S. Zeyrek, *po aty*, f. s. 324.

54 *Balkan Harbi Karadağ Cephesi*, V.III/3, f. 148.

55 Fahri Belen, *20. Yüzyıl Osmanlı Devleti*, Remzi Kitabevi, İstanbul, 1973, f. 169.

malazezve. Por përfundimisht dorëzimi është kryer me 23 nëntor 1913, dhe flamuri i tyre në kala është dukur për herë të fundit deri me 19 maj 1914.⁵⁶

Si rezultat i ndarjes së 5 vilajeteve me shumicë shqiptare të Perandorisë Osmane në Ballkan, të cilat ishin Shkodra, Janina, Selaniku, Manastiri dhe Kosova, shtetet që pushtuan tokat shqiptare u zgjeruan dhe morën territore si më poshtë:

- Greçia – 50 000 km², dhe 1 600 000 banorë;
- Serbia – 30 000 km², dhe 1 200 000 banorë;
- Bullgaria – 18 000 km², dhe 100 000 banorë;
- Mali i Zi – 5 000 km², dhe 150 000 banorë.⁵⁷

Edhe pse sllavët dhe grekët u zgjeruan me shumë toka shqiptare, grabitën, plaçkitën, bënë masakra e gjenocid mbi shqiptarët, “*Konferenca e Ambasadorëve në Londër, e mbajtur në vitin 1913 e njohu Pavarësinë e Shqipërisë*”⁵⁸ dhe po ashtu përcaktoi edhe kufijtë e sotëm.

Bibliografia

1. Agim Parruca, *Shkodra (Scutari), Shkodra Bastion i Qytetërimit Shqiptar*, Tiranë, 2004.
2. Ali Fuat Ögrenç, *Balkanlarda İlk Dram: Unuttuğumuz Mora Türkleri ve Eyaletten Bağımsızlığa Yunanistan*, BKY Yay., İstanbul 2009.
3. Barbara Jelavich, *Balkan Tarihi 20. Yüzyıl*, c.II, (Çev. Zehra Savan-Hatice Uğur), Küre Yay., İstanbul 2006.
4. Bilgin Çelik, “Balkanlarda Arnavut Sorunu”, *Cumhuriyet Strateji*, Ocak 2005.
5. BOA, *Babiali Evrak Odası (BEO)*, no. 305439; BOA, *BEO*, no. 3997/299737; BOA, *BEO*, no. 4081/306012; BOA, *BEO*, no. 4095/307064; BOA, *BEO*, no. 4140/310493; BOA, *BEO*, no. 4801/306064; *BEO*, no. 4029/302146; BOA, *BEO*, no.3993/299449.
6. Bonyar Waylet-Ernst Jackh, *İmparatorluk Stratejileri ve Ortadoğu*:

56 Agim Parruca, *Shkodra Bastion i Qytetërimit Shqiptar*, Tiranë, 2004, f. 96.

57 İbrahim Artuç, *Balkan Savaşı*, Kastaş Yayınları, İstanbul, 1988, f. 331.

58 Wilhelm Feldmann, İstanbul'da Savaş Günleri: Bir Alman Gazetecinin Balkan Savaşı *Hatıratı*, (Çev. N. Alkan), Selis Kitaplar, İstanbul, 2004, f.14.

- Doğuda* İngiliz Alman Rekabeti ve Balkan Savaşından Sonra Almanya, Chivi yazıları Yay., İstanbul, 2004.
7. Cevdet Küçük, “Balkan Savaşı”, Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi (*DİA*), İstanbul 1992, c. V.
 8. Charles Jelavich & Barbara Jelavich, (1986). The establishment of the Balkan national states, 1804–1920. University of Washington Press.
 9. Edward J. Erickson, *Defeat in Detail: The Ottoman Army in the Balkans, 1912-1913*, London 2003; Zekeriya Türkmen, “Balkan Savaşlarında Hilal-i Ahmer Cemiyeti’nin Osmanlı Ordusuna Yönelik Sağlık Hizmetleri”, *Belleten*, (Ankara 2005), c. LXVIII.
 10. Enver Ziya Karal, İkinci Meşrutiyet ve Birinci Dünya Savaşı (1908-1918), TTK Yayınları, V. 9, 3. baskı, Ankara 2001.
 11. Halil İnalçık, *Arnavutlukta Osmanlı Hakimiyetinin Yerleşmesi ve İskender Bey İsyanının Menşei*, “*Fatih ve İstanbul Dergisi*”, V. I., No: II., ff. 152-175, İstanbul 1953.
 12. Halil İnalçık, Süret-i Defter-i Sancak-i Arvanid, Türk Tarih Kurumu Basımevi, II. Ankara 1987.
 13. İbrahim Artuç, *Balkan Savaşı*, Kastaş Yayınları, İstanbul 1988..
 14. İsmail Hami Danişmend, İzahlı Osmanlı Tarihi Kronolojisi, İstanbul 2011, c. 4.
 15. Machiel Kiel, “İşkodra”, *Türk Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi (DİA)*, İstanbul 2001, V. 23.
 16. Mahmud Belig Uzdil, *Balkan Savaşı’nda Mürettep 1-Nci Kolordunun Harekâtı*, (Yay. Haz: A. Tetik-Ş. Büyükcın), Ankara 2006.
 17. Mahmud Celaleddin, *Hoca Tahsin Efendi ile Mükalememiz (Röportaj)*, Hazine-i Evrak Mecmuası No: 22, ff. 343-347, 2 Temmuz 1881, Türkçe transkripsiyon ve tercüme Sidita Brahaj, 2018.
 18. Muzaffer Tepekaya, “Osmanlı-Alman İlişkileri (1870-1914)”, *Türkler*, Yeni Türkiye Yayınları, c. 13, Ankara 2002.
 19. Nathalie Clayer, *Aux origines du nationalisme albanais: la naissance d’une nation majoritairement musulmane en Europe*, Kartala, 2007.
 20. Necdet Hayta, *Ege Adaları Sorunu 1911’den Günümüze*, Gazi Kitapevi Yay., Ankara 2006.
 21. Oya Şenyurt, “II. Mahmud’un Saltanatının Son Yıllarında İşkodra Kalesi ve Çevresi”, *Tarih ve Uygarlık İstanbul Dergisi*, 4, Aralık 2013.
 22. Perparim Rexhepi, *Mbrojtja E Shkodrës (1912-1913)*, Tiranë 2001.

23. Reginald Rankin, *The Inner History of The Balkan War*, London 1914.
24. Richard C. Hall, *The Balkan Wars 1912-1913, Prelude to the First World War*, London 2000.
25. *Salname-i Vilayet-i İşkodra (SVİ)*, Sene 1310.
26. Sami Frashëri/Şemsedin Sami, *Kamusü'l-Alâm*, Dersaadet 1316, V. II.
27. Ali Bardhi, *Müfettiş Davut Boriçi'nin Günlüğünde (1870-1877) İşkodra Vilayeti'nde Eğitim*, Marmara Üniversitesi, Yüksek Lisans Tezi, İstanbul 2009.
28. Selim Aydın, *Balkanların Acı Yüzü: Basın Tarihinde Balkan Savaşları*, Yeditepe yayınları, İstanbul 2013.
29. Süleyman Kani İrtem, *Osmanlı Devleti'nin Makedonya Meselesi, Balkanların Kördüğümü*, Temel Yay., İstanbul 1999.
30. Süleyman Külçe, *Osmanlı Tarihi'nde Arnavutluk*, İzmir 1944.
31. *Türk Silahlı Kuvvetler Tarihi, Osmanlı Devri, Balkan Harbi*, Genelkurmay Yay., c. II/1-2, Ankara 1993.
32. Von Zambaur, Hortense, *Rrethimi i Shkodres (10 Tetor 1912 deri me 22 Prill 1913)* Perkthyer: Ferit Hafizi, Shkodër 2006.
33. Wilhelm Feldmann, İstanbul'da Savaş Günleri: Bir Alman Gazetecinin Balkan Savaşı Hatıratı, Selis Kitaplar, İstanbul, 2004.
34. Yakup Ahabab, "The Shkodra Banner Administrative Structure During The Tanzimat Period (1839-1876)", *Balkan Studies History&Literature*, (Ed. Deniz Ekinci), V. II, Arnavutluk 2012.
35. Yusuf Hikmet Bayur, *Türk İnkılap Tarihi-III (Trablusgarp ve Balkan Savaşları Osmanlı Asyasının Paylaşılması için Anlaşmalar-1911 başından Balkan Savaşı'na Kadar)*, TTK Yay., Ankara, 1983.

HORIZONTE SHOQERORE

Univers

